

Programi IPA 2013 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë



Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën

(EuropeAid/135700/DH/SER/AL)

Draft 3

Projektligji mbi Ndryshimet Klimatike

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian





Titulli i Projektit:	Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën
Akronimi i Projektit:	IBECA
Numri i Projektit:	Europe Aid/135700/DH/SER/AL
Data e fillimit të projektit:	22 qershor 2015
Kohëzgjatja e projektit:	36 muaj
Autoriteti Kontraktues:	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri ABA Business Centre Rruga Papa Gjon Pali II, Tirana, Albania. Z. Kai NAGEL, Menaxher Sektori, Mjedisi & Energjia Tel: +355 4 222 8320, Fax: +355 4 223 0752 e-mail: Kai.NAGEL@eeas.europa.eu
Përfituesi:	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Rruga "Norbert Jokl", ish ATSH, Tiranë, Shqipëri. Evisi Kopliku Drejtor, Drejtoria e Integritimit, Koordinimit, Marreveshjeve dhe Asistences Mob: +355694397595 e-mail: Evisi.Kopliku@turizmi.gov.al
Kontraktori:	Agrotec SpA Lungotevere Michelangelo, 9 - 00192 Roma, Italia Kastriot Koshaj Menaxher Projekti Tel: +39 063609381, Fax: +39 0636093861 e-mail: info@agrotec-spa.net
Titulli i Dokumentit:	Draft 3 i Projektligjit mbi Ndryshimet klimatike

Shënim:

Ky raport është përgatitur nga një ekip i projektit që punon për Agrotec. Gjetjet, konkluzionet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë vetëm të Agrotec dhe nuk duhet të konsiderohen në asnjë mënyrë sikur reflektojnë opinionet dhe politikat e Komisionit Evropian.

Autorët e Projektligjit:

Prof.Ass.Dr.MSc. Narin PANARITI – Zevendes Drejtuese e Projektit – narin_panariti@yahoo.co.uk
Elena STEFANONI – Eksperte Ligjore – elena.stefanoni@yahoo.com

Data e Projektligjit: 20 Qershor 2018

Tabela e përmbajtjes

KREU I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	5
Neni 1 - Qëllimi	5
Neni 2 - Fusha e zbatimit	6
Neni 3 - Përkufizime	6
Neni 4 - Parimet	8
KREU II	9
Zbutja dhe përshtatja	9
Seksioni 1	9
Shkarkimet e GES nga instalimet e palëvizëshme	9
Neni 5 - Leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES	9
Neni 6 - Informacioni që duhet shtuar në aplikimin për leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES	9
Neni 7- Kushtet për dhënien e lejes së mjedisit që përfshin shkarkimet e GES	10
Neni 8 - Kërkesat që duhet të përmbajë leja e mjedisit lidhur me shkarkimet e GES	10
Neni 9 - Ndryshime të instalimeve	10
Neni 10 - Monitorimi dhe raportimi i shkarkimeve të GES nga instalimet e palëvizëshme	11
Neni 11 - Verifikimi dhe akreditimi	11
Seksioni 2	11
Shkarkimet CO ₂ nga sektori i transportit	11
Neni 12 - Planet e monitorimit dhe të raportimit të shkarkimeve të CO ₂ nga aviacioni ndërkombëtar	11
Neni 13 - Verifikimi dhe akreditimi	12
Neni 14 - Shkarkimet CO ₂ nga lundrimi ndërkombëtar	12
Neni 15 - Shkarkimet e CO ₂ nga aktivitetet e transportit rrugor	12
Seksioni 3 - Shkarkimet e GES nga sektorë të tjerë	12
Neni 16 - Sektori i energjisë	13
Neni 17 - Sektori i ndërtimit	13
Seksioni 4 - Shkarkimet e GES nga përdorimi i disa produkteve	13
Seksioni 5	14

Përthithja dhe depozitimi i shkarkimeve të GES.....	14
Seksioni 6 - Strategjitë për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe adaptimin ndaj tyre.....	15
Seksioni 7 - Matja, raportimi dhe verifikimi (MRV)	17
KREU III.....	18
Autoritetet Kompetente	18
KREU IV.....	20
Ndërtimi i kapaciteteve, edukimi, trajnimi, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut	20
KREU V.....	20
Investimet dhe financimet e gjelbërta.....	20
KREU VI.....	22
Dispozita kalimtare dhe të fundit	22
Neni 40 - Menaxhimi i informacionit	22
Neni 41 - Përputhshmëria e operatorëve me kërkesat e këtij ligji	23
Neni 42 - Raportimi mbi zbatimin e Seksionit 1 dhe 2 të këtij ligji	23
Neni 43 - Aktet nën-ligjore.....	23
Neni 44 - Akte nën-ligjore që mbeten në fuqi	23
Neni 45 - Shfuqizime	24
Neni 46 - Kundërvajtjet	24
Neni 47 - Hyrja në fuqi	24
Aneksi I: Gazet me Efekt Serrë.....	25
Aneksi II: Kategoritë e aktiviteteve dhe GES që i nënshtrohen kërkesave të këtij ligji.....	26
Aneksi III: Lista e aktiviteteve të aviacionit që përjashtohen nga ky ligj.....	29
Aneksi IV: Lista jo-shterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin “Përcaktimi i kontributit kombëtar të pikësnyuar (NDC)”	30
Aneksi V: Lista jo-shterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin LCDS.....	31
Aneksi VI: Lista jo-shterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin NAMA	32
Aneksi VII: Lista jo-shterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin “Strategjia dhe Plani Kombëtar për Përshtatje (NAP)”	34
Aneksi VIII: Lista jo-shterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin Komunikimi Kombëtar	35
Aneksi IX: Lista jo-shterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin BUR.....	36



PROJEKTLIGJ
Nr. ...date2017

PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 - Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të krijojë bazën ligjore për integrimin e politikave dhe për masa efektive që mundësojnë:

- a. plotësimin e detyrimeve të RSH ndaj Konventës për arritjen e objektivit final të saj, përmes nxitjes së reduktimit të shkarkimeve të GES dhe ruajtjes dhe rritjes së përthithësve dhe rezervuarëve të vendit;
- b. përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar dhe/ose lokal; dhe

¹Ky Ligj transponon pjesërisht:

- Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 Tetor 2003 për krijimin e një skeme për tregtinë e e lejeve për shkarkimet e gazeve serrë brenda Komunitetit dhe që amendon Direktivën e Këshillit 96/61/EC (CELEX 32003L0087) të amenduar nga:
- Direktivën 2004/101/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 27 Tetor 2004 që amendon Direktivën 2003/87/EC për krijimin e një skeme për tregtinë e e lejeve për shkarkimet e gazeve serrë brenda Komunitetit në zbatim të mekanizmave të projektit të Protokollit të Kiotos (CELEX 32004L0101)
- Direktivën 2008/101/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 19 Nëntor 2008 që amendon Direktivën 2003/87/EC duke përfshirë aktivitetet e aviacionit në skemën për tregtinë e e lejeve për shkarkimet e gazeve serrë brenda Komunitetit (CELEX 32008L0101)
- Direktivën 2009/29/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 Prill 2009 që amendon Direktivën 2003/87/EC duke përmirësuar dhe zgjeruar skemën për tregtinë e e lejeve për shkarkimet e gazeve serrë brenda Komunitetit (CELEX 32009L0029)

- c. evidentimin e arritjeve të vendit në këto drejtime duke përdorur metodologji sipas modeleve të Konventës dhe të BE-së.

Neni 2 - Fusha e zbatimit

Ky Ligj dhe aktet e tij nën-ligjore ngrenë kuadrin institucional dhe rregullojnë masat për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të GES në nivelin e sektorëve/burimeve dhe në nivel kombëtar në përputhje me angazhimet kombëtare, buxhetin e vendit dhe financimet ndërkombëtare.

Neni 3 - Përkufizime

Në këtë Ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Efekte të dëmshme të ndryshimeve klimatike" janë ndryshimet në mjedisin fizik apo biotë që rezultojnë nga ndryshimet klimatike, të cilat kanë efekte të rëndësishme negative mbi përbërjen, aftësinë vetëpërtëritëse, produktivitetin e ekosistemeve natyrore apo të menaxhuara, funksionimin e sistemeve socio-ekonomike apo mbi shëndetin dhe mirëqënien e njeriut.
2. "Ndryshim klimatik" është një ndryshim i klimës që i atribuohet direkt apo indirekt aktivitetit të njeriut, i cili ndryshon përbërjen e atmosferës globale dhe që i shtohet ndryshueshmërisë natyrore të klimës që vërehet në periudha kohe të krahasueshme.
3. "Sistem i klimës" është tërësia e atmosferës, hidrosferës, biosferës dhe gjeosferës dhe ndërveprimeve të tyre.
4. "Shkarkime" janë clirimet nga aktivitetet antropogjene të GES dhe/ose prekursorëve të tyre në atmosferë në një sipërfaqe dhe periudhë kohe të caktuar.
5. "Rezervuar" është një përbërës apo përbërësit e sistemit të klimës ku depozitohet një GES apo një prekursor i GES.
6. "Përthithës" është cdo proces, aktivitet apo mekanizëm që largon një GES, një aerosol apo një prekursor të GES nga atmosfera.
7. "Burim" është cdo proces apo aktivitet që cliron një GES, një aerosol apo një prekursor të GES nga atmosfera.
8. "Konventa" është Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuar për Ndryshimet Klimatike, e miratuar në New York në 9 Maj 1992, e cila në RSH ka hyrë në fuqi që në 1 Janar 1995 dhe ku RSH është palë jo-Aneks I.
9. "Protokolli i Kiotos" është Protokolli i Kiotos i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuar për Ndryshimet Klimatike, i miratuar në Kioto në 11 Dhjetor 1997, i cili për RSH ka hyrë në fuqi në 30 qershor 2005.
10. "Kapja dhe depozitimi gjeologjik i dioksidit të karbonit (CO₂)" është një teknologji e ndërmjetme/lidhëse që synon të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Ajo konsiston në kapjen e CO₂ nga instalimet industriale, transportin e tij në një vend depozitimi dhe injektimin në një formacion gjeologjik të përshtatshëm nën tokë për qëllime ruajtje të përherëshme.
11. "GES" – "Gaz me Efekt Serrë" janë gazet që gjenden në atmosferë në gjendje natyrore dhe të shkaktuar nga aktivitetet antropogjene, të cilat përthithin dhe ri-emetojnë rrezatimin infra të kuq. Lista e GES të shkarkuar nga aktivitetet antropogjene që mbulohen nga ky Ligj janë të listuar në Aneksin I.

12. “Leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES” është leja e mjedisit që përmban edhe kushte për GES dhe që lëshohet në përputhje me kërkesat e ligjit për lejet e mjedisit dhe seksionit 1 të këtij ligji.
13. “Instalim” është një njësi teknike e palëvizëshme ku kryhen një apo më shumë aktivitete që bëjnë pjesë në Aneksin II Pjesa A të këtij ligji dhe cdo aktivitet tjetër shoqërues që ka lidhje teknike me aktivitetet e kryera në atë vendndodhje dhe që mund të ketë ndonjë efekt mbi shkarkimet dhe ndotjen;
14. “Ton ekuivalent dioksid karboni” është një ton metrik dioksid karboni (CO₂) ose një sasi e cfarëdo GES tjetër të listës në Aneksin I që ka potencial equivalent për ngrohje globale;
15. “Djegje” është oksidimi i lëndës djegëse, pavarësisht mënyrës se si përdoret nxehtësia, energjia elektrike apo mekanike e prodhuar nga ky process dhe cdo aktivitet tjetër që lidhet drejtpërdrejt me të, përfshirë pastrimin e mbetjeve të gazta;
16. “Politika dhe masa” janë të gjithë instrumentet që synojnë të zbatojnë angazhimet që lidhen me zbutjen e ndryshimeve klimatike duke kufizuar shkarkimet antropogjene të GES dhe mbrojtjen dhe shtimin e përthithësve dhe rezervuarëve dhe që mund të përfshijnë edhe ato që nuk kanë si objektiv parësor kufizimin dhe reduktimin e shkarkimeve të GES;
17. “Investime miqësore ndaj klimës” janë investimet në teknologji që shkarkon pak karbon apo që cojnë në ripërtëritjen e klimës dhe që cojnë drejt një ekonomie me pak karbon që e kufizon ngrohjen global në 2°C – politikë e BE-së / që është në linjë me reduktimet e nevojshme për arritjen e objektivit politik të BE-së për reduktimin e ngrohjes globale në 2°C.
18. “Transferim i teknologjisë” është një tërësi procesesh që mbulojnë lëvizjet e *knoë-hoë*, të eksperiencës dhe paisjeve për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre midis aktorëve të ndryshëm si qeveritë, entet private, institucionet financiare, OJQtë dhe institucionet kërkimore/arsimore.
19. “Integrim” nënkupton integrimin e objektivave, strategjive, politikave, masave apo operacioneve të zbutjes dhe/ose të përshtatjes në mënyrë të tillë që ato të bëhen pjesë e politikave, proceseve dhe buxheteve të zhvillimit rajonal dhe kombëtar në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat.
20. “Përshtatje” janë rregullimet e bëra nga njeriu në sistemet ekologjike, sociale apo ekonomike apo proceset politike, në përgjigje të ndryshimeve aktuale apo të pritshme të klimës dhe efekteve apo ndikimeve të tyre.
21. “Zbutje” janë të gjitha përpjekjet e bëra për të reduktuar apo parandaluar shkarkimet e GES, përfshirë përdorimin e teknologjive të reja dhe energjive të rinovueshme, që i bëjnë paisjet e vjetra më eficiente ndaj konsumit të energjisë apo ndryshojnë praktikatat e menaxhimit apo sjelljen e konsumatorit.
22. “NAMA” - “Masa Zbutëse të Përshtatëshme për Vendin” janë instrumenta zbatues të Strategjive të Zhvillimit me Pak Karbon (LCDS). Këto janë masa që merren për zbutjen e ndryshimeve klimatike në kuadër të veprimeve kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm. NAMA mbështeten dhe mundësohen nga teknologjia, financimet dhe forcimi i kapaciteteve përmes procesit të monitorimit, raportimit dhe verifikimit (MRV).
23. “Operator”, njëlloj si në ligjin për lejet e mjedisit është personi fizik apo juridik që operon ose kontrollon instalimin, apo të cilit i është deleguar fuqi ekonomike vendimtare për funksionet teknike të instalimit;
24. “Operator avioni” është personi që operon një avion në kohën kur ai kryen një aktivitet avjacioni sipas përcaktimit të këtij ligji, me përjashtim të operacioneve të listuara në Pjesën B të Aneksit II

- ose, kur ky person nuk njihet apo nuk identifikohet nga pronari i avionit, është vetë pronari i avionit;
25. “Operator i transportit ajror tregtar” është operatori që, kundrejt pagesës, ofron shërbime të planifikuara ose jo të planifikuara të shërbimit të transportit ajror for remuneration për publikun për transportin e udhëtarëve, të mallrave apo të postës.
 26. “Person” është cdo person fizik apo juridik;
 27. “Publik” janë një apo më shumë persona dhe, në përputhje me legjislacionin apo praktikën në fuqi, shoqata, organizata apo grupe personash;
 28. “Minister” është Ministri përgjegjës për mjedisin.
 29. “Ministri” është Ministria përgjegjëse për mjedisin.
 30. “AKM” është Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
 31. “NDC” është dokumenti që tregon nivelin e përpjekjeve për integrimin e politikave kombëtare të vendit për të dhënë kontributin e vet për stabilizimin global të ndryshimeve klimatike. Ky kontribut shkon përtej arritjeve të deritanishme të vendit.
 32. “CDM” është Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër që buron nga Protokolli i Kiotos.
 33. “NJQV” është Njësia e Qeverisjes Vendore.
 34. “Sistemi i Inventarit Kombëtar” është sistemi i rregullimeve institucionale, ligjore dhe procedurale të bëra në RSH për vlerësimin e shkarkimeve antropogjene nga burimet dhe përthithjen e tyre nga përthithësit të GES të listuar në Aneksin I, dhe për raportimin dhe arkivimin e informacionit të këtij inventari.
 35. “Inventari i GES” është inventari i shkarkimeve që përfshin shkarkimet e GES nga kategoritë e burimeve, si dhe përthithjen e tyre nga përthithësit e karbonit.
 36. “IGJEUM” është Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

Neni 4 - Parimet

1. Përvec sa përcaktohet në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”, masat për arritjen e objektivave të këtij ligji do të drejtohen edhe nga këto parime:
 - a. Parimi i përgjegjësive të përbashëta por të diferencuara. Ky nënkupton që masat dhe politikat kombëtare duhet të jenë proporcionale me përgjegjësitë dhe kapacitetet reale të vendit, të përshtatshme për kushtet specifike të tij dhe të koordinohen dhe të plotësojnë masat që merren në nivel ndërkombëtar.
 - b. Parimi i kujdesit paraprak. Ky nënkupton që masat duhen marrë në rradhë të parë për të parashikuar, parandaluar apo minimizuar shkaqet e ndryshimeve klimatike dhe për të zbutur efektet e tyre të dëmshme.
 - c. Parimi i efencës. Ky nënkupton që politikat dhe masat që merren për ndryshimet klimatike duhet të jenë kost-efektive në mënyrë të tillë që të sigurojnë përfitime globale me kostot më të ulta të mundëshme.
 - d. Parimi i integritimit. Ky nënkupton që politikat dhe masat që merren për të mbrojtur sistemin e klimës nga ndryshimet antropogjene duhet të përfshijnë të gjithë sektorët ekonomikë dhe të mbulojnë të gjitha burimet, përthithësit dhe rezervuarët e GES si dhe përshtatjen ndaj këtyre ndryshimeve. Integrimi i ndryshimeve klimatike duhet bërë në të gjitha politikat dhe praktikat ekzistuese dhe të ardhshme sektoriale dhe ndër-sektoriale.

- e. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm. Ky nënkupton që masat për mbrojtjen e sistemit të klimës nga ndryshimet antropogjene të integruara në politikën dhe programet e zhvillimit kombëtar duhet të cojnë në rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit.
- f. Parimi i bashkëpunimit dhe financimit ndërkombëtar. Ky nënkupton që përpjekjet për të trajtuar ndryshimet klimatike mund të bëhen bashkarisht dhe në koordinim me vende të tjera të interesuara dhe, përveç buxhetit të shtetit, të mbështeten edhe nga burime financimi ndërkombëtar apo bilateral.

KREU II - Zbutja dhe përshtatja

Seksioni 1 - Shkarkimet e GES nga instalimet e palëvizëshme

Neni 5 - Leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES

1. Pavarësisht kërkesave të legjislacionit për lejet e mjedisit, për mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe për Përbërësit Organikë të Avullueshëm, 6 vjet nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare operatorët e instalimeve që kryejnë cilindo nga aktivitetet e Aneksit II Pjesa A që shkarkojnë GES të listuara po aty, nuk mund të kryejnë aktivitetet e tyre po qe se nuk kanë marrë nga AKM një leje mjedisi që përfshin edhe shkarkimet e GES nga ana e tyre. Kjo leje do të ketë tipin A ose B sic përcaktohet në ligjin “Për lejet e mjedisit”. Nëse një aktivitet i Aneksit II nuk mbulohet nga ligji “Për lejet e mjedisit” ai do t’i nënshtrohet kërkesave edhe të atij ligji.
2. Operatori i një instalimi ekzistues të referuar në paragrafin 1, brenda 5 vjet nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, duhet të ketë aplikuar për plotësimin e lejes ekzistuese të mjedisit me kërkesat për shkarkimin e GES nga ana e tyre.
3. Duke filluar nga 5 vjet nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, operatori i një instalimi të ri të referuar në paragrafin 1, në aplikimin e tij për leje mjedisi duhet të përfshijë edhe informacion për shkarkimin e GES nga ana e tyre, në përputhje me kërkesat e nenit 6.
4. Brenda 4 vitesh nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, Ministri, miraton me Urdhër formatin e aplikimit për leje mjedisi që përfshin edhe shkarkimet e GES.

Neni 6 - Informacioni që duhet shtuar në aplikimin për leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES

1. Operatori i një instalimi të referuar në Nenin 5, paragrafi 1, që aplikon për leje mjedisi sipas paragrafit 2 apo 3 të atij neni, përveç informacionit të kërkuar në zbatim të ligjit për lejet e mjedisit, duhet të japë informacion edhe për:
 - a. Instalimin dhe aktivitetet e tij, përfshirë teknologjinë e përdorur;
 - b. Materialet dhe lëndët e para, përdorimi i të cilave mund të cojë në shkarkime të GES të listuara në Aneksin II;
 - c. Burimet e shkarkimeve të GES nga instalimet e listuara në Aneksin II; dhe
 - d. Masat e planifikuara prej tij për të monitoruar dhe raportuar shkarkimet e GES në përputhje me rregulloren e referuar në Nenin 11.
2. Detajet e referuara në paragrafin 1 duhet të përfshihen edhe në përmbledhjen ekzekutive jo-tekniqe të aplikimit për leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES.

Neni 7- Kushtet për dhënien e lejes së mjedisit që përfshin shkarkimet e GES

1. AKM do të lëshojë leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES për të gjithë apo për një pjesë të instalimit **nqse operatori është në gjendje të demonstrojë se ka marrë masat e nevojshme që të monitorojë dhe raportojë shkarkimet e GES sipas kërkesave të rregulloreve të referuara në Nenin 11 dhe 12.**

Neni 8 - Kërkesat që duhet të përmbajë leja e mjedisit lidhur me shkarkimet e GES

1. Leja e mjedisit e operatorit të instalimit që kryen cilindo nga aktivitetet e listuara në Aneksin II, që shkarkojnë GES të listuara po aty, për atë aktivitet specifik, që lëshohet në vijim të aplikimit sipas Nenit 5, paragrafi 2 ose 3, nuk do të kërkojë vendosjen e vlerave kufi për shkarkimin e gazeve që listohen aty.
2. Leja e mjedisit e referuar në paragrafin 1 do të përmbajë informacionin si më poshtë:
 - a. Emri dhe adresa e operatorit;
 - b. Përshkrim të aktiviteteve dhe shkarkimeve nga ai instalim;
 - c. Planin e monitorimit të shkarkimit të GES;
 - d. Kërkesat për raportim të shkarkimit të GES.
3. Kur operatori i referuar në paragrafin 1 operon një ose më shumë instalime në të njëjtën vendndodhje, AKM lëshon vetëm një leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES me kërkesa për këto shkarkime.
4. Plani i monitorimit të referuar në paragrafin 2 gërma c duhet të hartohet sipas kërkesave të rregullores së referuar në nenin 10.
5. AKM mund të lejojë operatorët të përditësojnë planin e monitorimit pa ndryshuar kërkesat që lidhen me shkarkimin e GES.
6. Pavarësisht nga paragrafi 5, operatorët do të dorëzojnë për miratim në AKM cdo plan monitorimi të përditësuar.
7. Brenda 4 vitesh nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, Ministri, miraton me Urdhër formatin e lejes së mjedisit që përfshin shkarkimet e GES.

Neni 9 - Ndryshime të instalimeve

1. Operatori duhet të informojë AKM për cdo ndryshim që planifikon të bëjë në natyrën apo funksionimin e instalimit, **apo cdo zgjerim a reduktim të rëndësishëm** të kapacitetit të vet, për të cilin mund të nevojitet përditësimi i kërkesave të lejes së mjedisit lidhur me shkarkimin e GES.
2. Ndryshimi i rëndësishëm i kapacitetit, sic referohet në paragrafin 1, nënkupton një ndryshim në funksionim, i cili sipas gjykimit të AKM, arrin pragun e kapacitetit prodhues apo sasinë e prodhimit të një instalimi të listuar në Aneksin II të këtij ligji.
3. Në vijim të informimit të referuar në paragrafin 1, nqse nevojitet, AKM do të përditësojë lejen e mjedisit.
4. AKM do të përditësojë lejen e mjedisit edhe me emrin dhe adresën e operatorit të ri, në rastin kur ndodh një ndryshim i tillë.

Neni 10 - Monitorimi dhe raportimi i shkarkimeve të GES nga instalimet e palëvizëshme

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton rregulloren për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO₂ dhe GES të tjerë nga disa aktivitete industriale dhe aviacioni ndërkombëtar. Aktivitetet industriale të referuara në paragrafin 1 janë ato të listuara në Aneksin II të këtij ligji.
2. Brenda 5 vitesh nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, në përputhje me rregulloren e referuar në paragrafin 1 operatori i njëinstalimi që kryen cilindo nga aktivitetet e listuara në Aneksin II, ka detyrimin të monitorojë shkarkimet që kryhen nga ai instalim gjatë vitit kalendarik dhe t'i raportojë në AKM pas përfundimit të cdo viti.
3. Për të minimizuar barrën e raportimeve mbi bizneset, Ministria do të marrë masa për të koordinuar kërkesat që operatorët kanë për raportim të shkarkimeve të GES me kërkesa të tjera raportuese të tyre.

Neni 11 - Verifikimi dhe akreditimi

1. Raporti i përgatitur nga operatori sipas kërkesave të rregullores së referuar në Nenin 10 do të verifikohet.
2. Në përputhje me rregulloren e referuar në paragrafin 4, operatori do të dërgojë raportin e shkarkimeve të GES për verifikim te një verifikues i akredituar, përpara se ta dorëzojë në AKM.
3. AKM nuk do të pranojë raportin e shkarkimeve të referuar në paragrafin 2, nëse ai nuk është verifikuar nga një verifikues i akredituar, në përputhje me rregulloren e referuar në paragrafin 4.
4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, do të miratojë rregulloren për verifikimin e raporteve të shkarkimeve të CO₂ dhe GES të tjerë nga disa aktivitete industriale dhe aviacioni ndërkombëtar dhe për akreditimin e verifikuesve.

Seksioni 2 - Shkarkimet CO₂ nga sektori i transportit

Neni 12 - Planet e monitorimit dhe të raportimit të shkarkimeve të CO₂ nga aviacioni ndërkombëtar

1. Brenda 5 vitesh nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, cdo operator avioni që ka një licencë të vlefshme të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për transportin, për fluturimet që nisen nga apo arrijnë në një aeroport që ndodhet në territorin e RSH, me përjashtim të atyre që listohen në Aneksin III të këtij ligji, kanë detyrimin të dorëzojnë në AKM planin e monitorimit për shkarkimet e CO₂ nga aktiviteti i aviacionit dhe aktivitetin në ton-kilometra në përputhje me kërkesat e rregullores së referuar në nenin 10, paragrafi 1 që lidhen me aviacionin ndërkombëtar.
2. AKM do të miratojë planet e monitorimit në përputhje me kërkesat e rregullores së referuar në nenin 10, paragrafi 1 që lidhen me aviacionin ndërkombëtar.
3. Brenda 5 vitesh nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, operatori i cdo avioni ka detyrimin të monitorojë shkarkimet e CO₂ dhe aktivitetin e tij në ton-km që kryen gjatë vitit kalendarik dhe t'i raportojë në AKM pas përfundimit të atij viti në përputhje me kërkesat e rregullores së referuar në nenin 10, paragrafi 1 që lidhen me aviacionin ndërkombëtar.

Neni 13 - Verifikimi dhe akreditimi

1. Raporti i shkarkimeve të CO₂ i përgatitur nga operatori i avionit sipas nenit 12, paragrafi 3 do të verifikohet.
2. Operatori i avionit përpara se ta dërgojë raportin e shkarkimeve të GES në AKM do ta dërgojë për verifikim te një verifikues i akredituar në përputhje me kërkesat e rregullores së referuar në nenin 11, paragrafi 4.

Neni 14 - Shkarkimet CO₂ nga lundrimi ndërkombëtar

1. Pavarësisht masave të kërkuara nga ligji “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit” dhe aktet nënligjore që lidhen me cilësinë e disa lëndëve të djegshme të lëngshme për përdorim në mjetet e transportit detar masa duhen marrë edhe për kontrollin dhe reduktimin e shkarkimeve të CO₂ dhe kontributin e tyre në ndryshimet klimatike.
2. Masat për kontrollin dhe/ose reduktimin e shkarkimeve të CO₂ nga lundrimi ndërkombëtar përfshijnë ato që lidhen me:
 - a. Monitorimin, Raportimin dhe Verifikimin e shkarkimeve të CO₂ dhe të cdo informacioni tjetër të ngjashëm nga anijet që mbërrijnë, futen apo nisen nga një port në RSH.
 - b. Eficencën e Përdorimit të Energjisë në Anije
 - c. Planin e Menaxhimit të Eficencës së Energjisë në Anije (SEEMP)
 - d. Planin e Menaxhimit të Karburanteve në Anije
3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit përgjegjës për transportin dhe të Ministrit, do të miratojë rregullat për zbatimin e masave të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, pika **a**.
4. Ministri përgjegjës për transportin dhe Ministri përgjegjës për energjinë nxitin zbatimin e masave të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, pikat **b**, **c** dhe **d**, dhe mund të nxjerrin udhëzime të përbashkëta për këtë qëllim.

Neni 15 - Shkarkimet e CO₂ nga aktivitetet e transportit rrugor

1. Pavarësisht masave të kërkuara nga ligji “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit” dhe aktet nënligjore që lidhen me të për reduktimin e shkarkimeve në ajër nga burime të lëvizëshme, masa duhen marrë edhe për kontrollin dhe reduktimin e shkarkimeve të CO₂ dhe kontributin e tyre në ndryshimet klimatike. Për këtë arsye, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit përgjegjës për transportin, do të miratojë Vendime për:
 - a. Monitorimin dhe raportimin e të dhënave për regjistrimin e automjeteve të reja për pasagjerë, lidhur me vlerësimin e reduktimit të shkarkimeve të CO₂ nga automjetet e lehta *light-duty vehicles*;
 - b. Monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO₂ nga automjetet e reja për pasagjerë;
 - c. Monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO₂ nga automjetet e reja të lehta tregtare *new light commercial vehicles*; dhe
 - d. Masat për sigurimin e informacionit mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ gjatë marketingut të automjeteve të reja.

Seksioni 3 - Shkarkimet e GES nga sektorë të tjerë

Neni 16 - Sektori i energjisë

Ministria përgjegjëse për energjinë do të nxisë zbatimin e masave për prodhimin e energjive të rinovueshme dhe/ose pa karbon dhe të masave për ruajtjen dhe efikasitetin e energjisë në të gjithë sektorët ekonomikë si masa të rëndësishme për reduktimin e shkarkimeve të GES dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike. Masa të tilla rregullohen nga ky ligj, legjislacioni për efikasitetin e energjisë, për burimet e energjisë së rinovueshme, si dhe me legjislacion tjetër të posacëm.

Neni 17 - Sektori i ndërtimit

Materialet e ndërtimit mund të luajnë një rol të rëndësishëm lidhur me ndryshimet klimatike, pasi potenciali i tyre izolues mund të ndihmojë si për reduktimin e konsumit të energjisë ashtu edhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Cilësia dhe standardet për prodhimin e materialeve të ndërtimit, kodet e ndërtimit dhe performanca e energjisë në ndërtesa rregullohen me legjislacion të posacëm.

Seksioni 4 - Shkarkimet e GES nga përdorimi i disa produkteve

Neni 18 - Lëndët djegëse dhe burimet e rinovueshme të energjisë, përfshirë bio-karburantet

1. Përveç masave që kërkohen nga ligji “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” dhe aktet nënligjore për cilësinë e lëndëve djegëse që synojnë reduktimin e shkarkimeve të ndotësve të ajrit, masa duhen marrë edhe për reduktimin e shkarkimeve të CO₂ dhe të kontributit të tyre në ndryshimet klimatike.
2. Për këtë arsye, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit përgjegjës për energjinë dhe Ministrit, do të miratojë vendimin për specifikimin e benzinës, diezelit dhe gazoilit dhe futjen e një mekanizmi për monitorimin dhe reduktimin e shkarkimeve të GES.

Neni 19 - Substancat ozon-holluese (ODS)

1. Masat për mbrojtjen e shtresës së ozonit rregullohen me këtë Ligj dhe me legjislacion tjetër të posacëm.
2. Masat për mbrojtjen e shtresës së ozonit përfshijnë nxjerrjen jashtë përdorimit të substancave ozon-holluese. Këto masa njëkohësisht kontribuojnë edhe për reduktimin e shkarkimeve të GES.
3. Substancat ozon-holluese duhen zëvendësuar nga produkte alternative që janë miqësore jo vetëm ndaj shtresës së ozonit por edhe ndaj sistemit të klimës.
4. Masat për zëvendësimin e substancave ozon-holluese nga produkte alternative që janë miqësore si ndaj ozonit ashtu edhe ndaj klimës mund të llogariten si masa të ndërmarra edhe për reduktimin e shkarkimeve të GES dhe të raportohen si të tilla.

Neni 20 - Gazet e florinuar

1. Masat për zbutjen e ndryshimeve klimatike përfshijnë edhe masat që reduktojnë, stabilizojnë dhe rregullojnë përdorimin, prodhimin, importin dhe eksportin e gazeve të florinuar, të cilat prodhohen nga njeriu për të zëvendësuar substancat ozon-holluese, por janë GES të fuqishëm dhe me shkarkime në rritje të madhe.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit dhe Ministrit përgjegjës për industrinë, do të miratojë vendime për:
 - a. Reduktimin dhe stabilizimin e GES të florinuar;
 - b. Formatin e raportit që dorëzohet nga prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit e disa GES të florinuar;
 - c. Kërkesat dhe kushtet minimale për njohjen reciproke të certifikimit të kompanive dhe dhe personelit të angazhuar me:
 - i. paisjet e palvizëshme për ftohjen, kondicionimin e ajrit, dhe pompat e nxehtësisë që përmbajnë disa GES të florinuara;
 - ii. sistemet e palëvizëshme për mbrojtjen nga zjarri dhe zjarrfikësit që përmbajnë disa GES të florinuara;
 - d. Kërkesat dhe kushtet minimale për njohjen reciproke të certifikimit të personelit të angazhuar me:
 - i. rikuperimin/kapjen e disa GES të florinuara nga kabinat e tensionit të lartë;
 - ii. rikuperimin/kapjen nga paisjet të disa solventëve me bazë GES të florinuara;
 - e. Shkarkimet nga sistemet e kondicionimit të ajrit në automjete;
 - f. Formatin e etiketave dhe kërkesa të tjera për etiketat e produkteve dhe paisjeve që përmbajnë disa GES të florinuara;
 - g. Kërkesat standard për kontrollin e rrjedhjeve për sistemet e palëvizëshme të:
 - a. mbrojtjes nga zjarri që përmbajnë disa GES të florinuara;
 - b. ftohjes, kondicionimit të ajrit dhe paisjeve me pompa nxehtësie që përmbajnë disa GES të florinuara
 - h. Kërkesat minimale për programet e trajnimit dhe kushtet për njohjen reciproke të atestimeve të trajnimit për personelin esistemeve të kondicionimit të ajrit në disa automjete që përmbajnë disa GES të florinuara
 - i. Formatin e njoftimit të trajnimit dhe programet e certifikimit.

Seksioni 5 - Përthithja dhe depozitimi i shkarkimeve të GES

Neni 21 - Pyjet dhe bujqësia (përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pylltaria)

1. Ministria, sipas rastit edhe në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për bujqësinë dhe/ose NJQVtë respektive, kur projekton dhe zhvillon politikat dhe masat për zbutje të ndryshimeve klimatike në fushën e pyjeve dhe të bujqësisë, do të synojnë reduktimin e shkarkimeve dhe kapjen e karbonit nga sektorët e bujqësisë, pylltarisë, përdorimeve të tjera të tokës dhe ruajtjes së ekosistemeve. Në mënyrë të vecantë ato duhet të angazhohen për të:
 - a. Pakësuar cpyllëzimet dhe degradimin e ekosistemeve pyjore dhe për t'i rikthyer ato në gjendjen e mëparshme, për të zgjeruar sipërfaqet e tokës me bimësi dhe me përmbajtje karboni organik duke zbatuar praktika të menaxhimit të qëndrueshëm në zonat bujqësore.
 - b. Kujdesur për ruajtjen, zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe shtimin e rezervave të karbonit në pyje.
 - c. Forcuar programet për menaxhimin e qëndrueshëm dhe restaurimin e ekosistemeve pyjore,

- ligatinore dhe bregdetare-detare.
- d. Përfshirë gradualisht më shumë ekosisteme në planet e ruajtjes, si psh njësitë e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe të reduktimit të shkarkimeve pasojë e shmangies së cpyllzimeve dhe degradimit të pyjeve.
 - e. Forcuar luftën kundër zjarreve në pyje.
 - f. Nxitur sinergjinë midis programeve dhe ndihmave për aktivitetet mjedisore dhe bujqësore, me qëllim që të forcohet lufta kundër zjarreve në pyje.
 - g. Projektuar dhe siguruar nxitësa ekonomikë për përthithjen e karbonit dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura natyrore dhe ekologjike.
2. NJQVtë do të informojnë cdo vit Ministrinë për aktivitetet e cpyllzimit dhe degradimit të pyjeve që kanë ndodhur në territorin nën juridiksionin e tyre përkatës.
 3. Ministria do të regjistrojë të dhënat për zonat që kanë pësuar cpyllzim dhe degradim për shkak të zgjerimit të tokave bujqësore, të kthimit në kullota, të zhvillimit infrastrukturor, të prerjeve të paligjshme dhe zjarreve.
 4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit dhe Ministrit përgjegjës për bujqësinë, do të miratojë vendimin për rregullat e përlogaritjes së shkarkimeve të GES dhe përthithjes së tyre që rezulton nga aktivitetet që lidhen me përdorimin e tokës, ndryshimin e përdorimit të tokës dhe pylltarisë si dhe për informacione të tjera që lidhen me këto aktivitete.

Neni 22 - Kapja dhe depozitimi gjeologjik i dioksidit të karbonit

1. Operatori i një instalimi të listuar në Aneksin II të këtij ligji, që shkarkon CO₂ mund të zgjedhë të zbusë këto shkarkime përmes kapjes dhe depozitimit të tij në formacione gjeologjike nën tokë, sipas kërkesave të përcaktuara në Vendimin e referuar në paragrafin 2.
2. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit dhe Ministrit përgjegjës për minierat, do të miratojë një Vendim për kapjen dhe depozitimin gjeologjik të dioksidit të karbonit në RSH.

Seksioni 6 - Strategjitë për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe adaptimin ndaj tyre

Neni 23 - Përcaktimi i kontributit kombëtar (NDC)

1. Dokumenti i NDC do të rishikohet cdo 5 vjet dhe nqse është e mundur do të përditësohet me synimin për ta rritur këtë kontribut në atë masë që lejojnë kushtet e vendit.
2. Ministria do të ko-ordinojë me Ministrinë e tjera të linjës dhe, sipas rastit edhe me aktorë të tjerë të përcaktuar prej saj, për përgatitjen e dokumentit të referuar në paragrafin 1.
3. Ministri do të miratojë udhëzimin dhe metodologjinë për hartimin dhe procesin e përgatitjes së dokumentit të referuar në paragrafin 1 sipas modelit të miratuar apo të rekomanduar nga Konventa dhe në përputhje me kushtet e vendit.
4. Dokumenti i referuar në paragrafin 1 duhet të përfshijë çështjet që jepen në listën jo-shterruese të Aneksit IV.
5. Dokumenti i referuar në paragrafin 4 duhet të jetë konsistent, përta i takon metodologjisë, që nga situata fillestare, komunikimi i kërkesave të tij dhe deri në zbatimin e tyre.

6. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, do të miratojë dokumentin “Përcaktimi i kontributit kombëtar” përpara se të dorëzohet në Sekretariatit e Konventës.

Neni 24 - Strategjitë e zhvillimit me pak karbon (LCDS)/ Strategjitë për zbutjen e ndryshimeve klimatike

1. Për të arritur objektivat e zhvillimit të vendit, duke ndjekur njëkohësisht një rrugë me përdorim më pak intensiv të karbonit, sic tregohet në dokumentin e NDC të referuar në nenin 23, të gjitha Ministrinë e linjës me përgjegjësi shtetërore në fusha që kanë ndikim mbi ndryshimet klimatike duhet të:
 - a. formulojnë Strategji Sektoriale Zhvillimi me Pak Karbon (LCDS) ose
 - b. integrojnë çështjet e zbutjes së ndikimeve të klimës në strategjitë e tyre ekzistuese të zhvillimit sektorial .
2. Ministria do të koordinojë procesin e integrimit të:
 - a. strategjive sektoriale të Zhvillimit me Pak Karbon (LCDS) në Strategjinë Kombëtare për Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike, ose
 - b. çështjeve të zbutjes së ndikimeve të klimës në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.
3. Strategjitë e referuara në paragrafin 1 dhe 2, duhet të pasohen nga planet përkatëse të zbatimit dhe të jenë të përshtatshme për vendin.
4. Pavarësisht nga kërkesa të tjera lidhur me formulimin e strategjive, procesi i përgatitjes së LCDS do të përfshijë sa më shumë të jetë e mundur nga lista jo-shterruese e çështjeve që jepen në Aneksin V.

Neni 25 - Masat zbutëse të përshtatshme për vendin (NAMAt)

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton rregullat për shqyrtimin dhe vlerësimin e masave zbutëse të përshtatshme për vendin në zbatim të Konventës.
2. Lista jo-shterruese e çështjeve që duhet trajtuar sa më shumë të jetë e mundur në një dokument NAMA jepet në Aneksin VI.

Neni 26 - Strategjia dhe Plani Kombëtar për Përshtatje (NAP)

1. Për të arritur objektivat e zhvillimit të vendit, duke adresuar njëkohësisht ndikimet e ndryshimeve klimatike, të gjitha Ministrinë e linjës me përgjegjësi shtetërore në fusha që ndikohen nga ndryshimet klimatike duhet të:
 - a. formulojnë strategji sektoriale për përshtatje; ose
 - b. integrojnë sfidat e përshtatjes dhe të reagimit ndaj ndryshimeve klimatike në strategjitë sektoriale ekzistuese të zhvillimit të tyre.
2. Ministria do të koordinojë procesin e integrimit të:
 - a. strategjive sektoriale për përshtatjetë referuara në paragrafin 1 në Strategjinë Kombëtare për Përshtatje; ose
 - b. sfidave të përshtatjes nëdokumentin ekzistues të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

3. Pavarësisht nga kërkesa të tjera lidhur me formulimin e strategjive, strategjitë e referuara në paragrafin 1 dhe 2 dhe/ ose përditësimet e tyre dhe të planeve të zbatimit të tyre do të përfshijnë sa më shumë të jetë e mundur çështjet që jepen në listën jo-shterruese në Aneksin VII.

Seksioni 7 - Matja, raportimi dhe verifikimi (MRV)

Neni 27 - Matja, raportimi dhe verifikimi (MRV)

1. MRV nënkupton matjen apo vlerësimin e bërë në RSH, raportimin si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe verifikimin QA/QC në nivel kombëtar dhe mbikqyrjen ndërkombëtare të shkarkimeve/ përthithjes apo shifrave të tjera që masin performancën, të përcaktuara në raportet e monitorimit të shkarkimeve të GES, inventarët e GES, NAMAT, Komunikimet Kombëtare dhe Raportet Azhornuese Dyvjecare.
2. MRV funksionon për shkarkimet, aksionet/masat dhe mbështetjen financiare.
3. Sistemi MRV ngrihet për të rritur transparencën mbi përpjekjet që bëhen për zbutjen e ndryshimeve klimatike. MRV synon të:
 - a. Masë, si përpjekjet për zbutjen e ndryshimeve klimatike, edhe ndikimin e zbatimit të NAMAVE, nivelin e shkarkimeve të GES dhe tërheqjen e tyre nga përthithësit, reduktimin e shkarkimeve dhe përfitime të tjera që referohen në Nenin 25 mbi NAMAT;
 - b. Raportojë informacionin e matur në mënyrë transparente dhe të standardizuar përmes Komunikimeve Kombëtare dhe the Raporteve Azhornuese Dyvjecare (BUR), sic referohet në Nenin 29;
 - c. Verifikojë dhe vlerësojë saktësinë, plotësinë, konsistencën dhe besueshmërinë e informacionit të raportuar përmes një procesi të pavarur.
4. MRV në RSH do të funksionojë si një sistem me qasje nga poshtë lart, me të dhëna që monitorohen fillimisht nga operatorët, operatorët e avionëve dhe të anijeve që janë subjekt i këtij ligji, përfshirë institucionet e varësisë sipas rastit, të cilat i raportohen Ministrive përkatëse të linjës sic përcaktohet në aktet nën-ligjore që burojnë nga ky ligj. Sistemi MRV do të trajtojë njëkohësisht edhe kërkesat ndërkombëtare.
5. Rregullat për monitorimin, raportimin dhe verifikimin janë përcaktuar në Nenin 10, 11, 12, 13, 14, 15, 18 të këtij ligji.

Neni 28 - Monitorimi dhe raportimi i shkarkimeve të GES dhe i informacioneve të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar

Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, do të miratojë rregulloren për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES dhe të informacioneve të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar. Ky vendim do të ngrejë Sistemin e Inventarit Kombëtar të GES dhe procedurat kombëtare për grumbullimin, përpunimin, raportimin, verifikimin dhe arkivimin e të dhënave dhe informacionit të kërkuar që janë funksionale, të qëndrueshme dhe të vazhdueshme. Ky dokument do të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë specifike të Ministrive të linjës, përvec atyre të përcaktuara në Nenin 30 të këtij ligji.

Neni 29 - Komunikimet Kombëtare (NC) dhe Raportet e Përditësimit Dyvjeçar (BUR)

1. Ministria do të organizojë dhe koordinojë me Ministrinë e linjës dhe institucione të tjera të përcaktuara prej saj, sipas rastit, punën për hartimin e Komunikimit Kombëtar (cdo katër vjet, apo në intervalet që mund të caktohen me vendime të mëvonshme të Konventës) dhe, nëse ka mbështetje financiare, edhe për Raportet e Përditësimit Dyvjeçar (cdo dy vjet), si detyrime raportuese të Konventës.
2. Komunikimi Kombëtar dhe Raporti i Përditësimit Dyvjeçar do të hartohen duke marrë parasysh prioritetet, objektivat dhe rrethanat e zhvillimit të vendit.
3. Komunikimi Kombëtar do të përfshijë sa më shumë të jetë e mundur informacionin që kërkohet nga lista-jo-shterruese në Aneksin VIII. Ai do të paraqitet si një dokument i vetëm, me një përmbledhje ekzekutive të informacionit të dhënë në dokumentin e plotë.
4. Qëllimi i BUR është të përditësojë për situatën pas Komunikimit Kombëtar më të fundit dhe përmban sa më shumë të jetë e mundur përmban çështjet e listës jo-shterruese që jepen në Aneksin IX.
5. BUR mund të dorëzohet ose si përmbledhje e pjesëve të Komunikimit Kombëtar në vitin kur ky dorëzohet, ose si raporte më vete.
6. Të dy dokumentet e referuar në paragrafin 1 do të përkthehen në anglisht.
7. Të dy dokumentet e referuar në paragrafin 1 do të paraqiten në mënyrë të kujdesëshme, konsistente, të kuptueshme, transparente dhe të krahasueshme, në kohën e duhur dhe në mënyrë fleksibël, duke marrë parasysh rrethanat specifike të vendit. Ato mund të përfshijnë gjithashtu informacion mbi mbështetjen që kërkohet për përgatitjen dhe përmirësimin e Komunikimit Kombëtar.
8. Këshilli i Ministrave/Ministri, miraton Komunikimin Kombëtar dhe Raportin e Përditësimit Dyvjeçar përpara se të dorëzohen pranë Konventës.
9. Të dy dokumentet e referuara në paragrafin 1 do të bëhen të disponueshme për publikun përmes faqes së internetit të Ministrisë.

KREU III - Autoritetet Kompetente

Neni 30 - Kuadri institucional dhe koordinimi ndër-ministor për raportimet

1. Për të lehtësuar koordinimin efektiv midis të gjithë aktorëve të sektorit publik e privat dhe për të siguruar një MRV me cilësi të lartë, në vazhdimësi dhe në kohë të Komunikimit Kombëtar dhe të Raportit të Përditësimit Dyvjeçar, si dhe për të trajtuar cdo masë tjetër për ndryshimet klimatike, bëhen rregullimet institucionale si më poshte:
 - a. Ministria është pika fokale kombëtare e Konventës dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe menaxhimin e sistemit MRV përfshirë procesin e përgatitjes së Komunikimit Kombëtar dhe të BUR.
 - b. AKM është Autoriteti Kompetent Kombëtar për të gjitha aktivitetet që lidhen me ngritjen dhe mbajtjen e Sistemit të Inventarit Kombëtar, si pjesë e Sistemit të Informacionit Mjedisor.
 - c. Të gjitha ministrinë e linjës, kompetencat e të cilave bien në fushat e përgjegjësisë shtetërore që ndikojnë apo ndikohen nga ndryshimet klimatike, kanë sipas rastit detyrimin të grumbullojnë dhe mbajnë të dhënat për aktivitetet, indikatorë specifikë/tematikë të agreguar dhe informacion që lidhet me klimën, dhe t'i ofrojnë Ministrisë kontributin e tyre me shkrim,

- në përputhje me kërkesat e rregullores dhe procedurave që referohen në nenin 28. Ato kooperojnë efektivisht deri në finalizimin dhe miratimin e të gjithë dokumenteve.
- d. INSTAT ka detyrimin t'i ofrojë Ministrisë të gjithë të dhënat socio-ekonomike, të popullsisë dhe të tjera që lidhen me to.
 - e. Të gjitha institucionet publike dhe private, aktivitetet e të cilave bien në fushat e përgjegjësisë shtetërore që jepen në paragrafin 2 do të grumbullojnë, organizojnë dhe mbajnë, sipas rastit, të dhënat e tyre mbi klimën bashkë me raportet përkatëse, dhe t'i vënë në dispozicion të Ministrisë përkatëse.
 - f. Ministritë e tjera të linjës dhe institucionet publike dhe private aktivitetet e të cilave nuk bien në fushat e përgjegjësisë shtetërore që jepen në paragrafin 2 do të kontribuojnë sipas rastit, me kërkesën e Ministrisë.
 - g. IGJEUM, institutet e tjera kërkimore-shkencore dhe universitetet, publike apo private, që kryejnë matje, kërkime apo studime lidhur me klimën, kanë detyrimin t'i vënë këto në dispozicion të Ministrisë/AKM-së.
 - h. NJPV-të për territorin nën juridiksionin e vet, kanë detyrimin të grumbullojnë, organizojnë dhe mbajnë të dhënat e tyre mbi klimën bashkë me raportet për masat e marra apo të planifikuara për zbutjen dhe adaptimin dhe t'i vënë në dispozicion të ministrisë dhe ministrisë përkatëse të linjës.
 - i. Ministri, bazuar në dokumentet më të fundit të promovuara nga Konventa dhe në rrethanat specifike socio-ekonomike të vendit, miraton Udhëzuesit Kombëtarë për përgatitjen e Komunikimit Kombëtar, të BURs, të vlerësimit të pasigurisë dhe metodologji të tjera që nevoiten për zbatimin e këtij ligji, përfshirë metodat/tiers, faktorët e shkarkimeve, të dhënat për aktivitetet, GES që do të trajtohen në document, etj, që janë të përshtatshme për RSH.
 - j. Të gjitha institucionet që referohen në këtë nen kanë detyrimin të ofrojnë mbështetje teknike dhe shkencore për përgatitjen e udhëzuesve kombëtarë të referuar në gërmën i të këtij paragrafi.
2. Fushat e përgjegjësisë shtetërore të referuara në gërmën c përfshijnë industrinë energjitike, industrinë prodhuese, të ndërtimit, të lëndëve djegëse, të minierave dhe gjeologjisë, të pyjeve, bujqësisë dhe blegtorisë, të menaxhimit të ujit, të menaxhimit të mbetjeve, të shëndetit, të transportit e infrastrukturës (përfshirë atë rrugore e hekurudhore, portet dhe aeroportet, tubacionet, digat, ujin dhe ujërat e zeza), planifikimin urban, menaxhimin e tokës, turizmin, arsimin, emergjencat civile dhe fatkeqësitë natyrore.
 3. Me qëllim promovimin dhe mbështetjen e koordinimit midis Ministrive të linjës dhe për të siguruar përdorimin e tyre në procese dhe plane të tjera kombëtare, Kryeministri, me propozim të Ministrit, miraton një Urdhër për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërministror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike.

Neni 31 - Integrimi i politikave dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Të gjitha ministritë e linjës dhe NJQVtë kanë detyrimin të sigurojnë integrimin e çështjeve të zbutjes së ndryshimeve klimatike dhe të përshtatjes ndaj tyre në legjislacionin, planet, programet dhe projektet e tyre.
2. Të gjitha ministritë e linjës dhe NJQVtë do të bashkëpunojnë për zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve që trajtojnë ndryshimet klimatike në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm.

3. Të gjitha ministritë e linjës do të koeporojnë me komunitetin ndërkombëtar për zbatimin e Konventës dhe do të inkurajojnë iniciativat dypalëshe dhe shumëpalëshe që synojnë këmbimin dhe ndarjen e informacionit mbi eksperiencat që lidhen me hartimin e politikave dhe praktikave të mira ekzistuese që kontribuojnë për zhvillimin e ekonomive me pak karbon dhe për të mbështetur dhe përhapur masat që lidhen me klimën.

KREU IV - Ndërtimi i kapaciteteve, edukimi, trajnimi, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut

Neni 32 - Ndërtimi i kapaciteteve

1. Të gjitha ministritë e linjës do të nxitin dhe do të mbështesin në mënyrë efektive, eficiente, të integruar dhe të programuar ndërtimin e kapaciteteve të tyre, të NJQVve, të institucioneve financiare, të sektorit privat e të OJFve për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në fushat e përgjegjësisë së tyre shtetërore.

Neni 33 - Edukimi dhe trajnimi

1. Ministria përgjegjëse për arsimin në bashkëpunim me Ministrinë do të marrin masa që nxitin dhe mbështesin hartimin dhe zbatimin e programeve në fushën e mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike për të gjitha nivelet e arsimit.
2. Ministria do të bashkëpunojë me Ministrinë përgjegjëse për arsimin lidhur me përmbajtjen e teksteve shkollorë dhe materialeve të tjera didaktike dhe do të nxitë pjesëmarrjen e institucioneve arsimore të të gjitha niveleve në iniciativa për kërkime shkencore, edukim dhe trajnim në fushën e mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike si në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
3. Ministria përgjegjëse për arsimin, në bashkëpunim me Ministrinë dhe Ministrinë përgjegjëse për punën, do të marrin masa që nxitin dhe mbështesin hartimin dhe zbatimin e programeve të edukimit në vazhdim në fushën e mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike.

Neni 34 - Informacioni dhe ndërgjegjësimi publik

1. Të gjitha ministritë e linjës, brenda fushave të kompetencave shtetërore përkatëse, do të ndërmerren fushata informacioni për të sensibilizuar dhe ndërgjegjësuar popullatën për efektet negative të ndryshimeve klimatike dhe për masat konkrete që mund të marrin për reduktimin e shkarkimeve të GES dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në zbatim të kërkesave të këtij ligji dhe objektivave strategjike të vendit në këtë fushë.

Neni 35 - Pjesëmarrja publike

1. Të gjitha ministritë e linjës, kur përgatisin/përditësojnë legjislacionin dhe strategjitë e tyre në lidhje me klimën do të nxitin pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të interesuar, përfshirë NJQVtë, sektorin privat dhe publikun.
2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes për mjedisin përcaktohet në akte ligjore të posacme.

KREU V - Investimet dhe financimet e gjelbërta

Neni 36 - Nxitja e investimeve miqësore ndaj mjedisit/ klimës

1. Të gjitha ministritë e linjës do të hartojnë politika që nxisin sektorin publik dhe privat për investime të konsiderueshme që shkarkojnë pak GES, që janë transparente, që kanë rezultate të parashikueshme dhe që janë pak të ndikueshme nga ndryshimet klimatike dhe inkurajojnë ndërmarrjet, institucionet, grupet sociale dhe individët për të ndjekur dhe për t'ju përshtatur progresit dhe inovacionit teknologjik, zbatimit të rezultateve të shkencës dhe teknologjisë, zhvillimit të arsimit dhe industrisë në zbatim të kërkesave të këtij ligji.
2. Të gjitha ministritë e linjës do të përditësojnë politikat/dokumentat kombëtare në mënyrë që të nxitin investimet për projekte miqësore ndaj klimës, do të mbështetin kërkimin shkencor dhe do të nxitin praktikën më të mire në fushat prioritare si më poshtë:
 - a. Në fushën e prodhimit të energjisë: energjitë e rinovueshme, shpërndarja, menaxhimi i shpërndarjes, ruajtja e energjisë, produktet/ teknologjitë që mbështetin sistemet energjitike inteligjente, qendrat e të dhënave për përdorimin e energjive të rinovueshme;
 - b. Në fushën e efikasitetit të energjisë: ndërtesat tregtare të gjelbërta, kreditë për banesa të gjelbërta, teknologjitë dhe produktet me përdorim eficient të energjisë, përmirësimet e teknologjisë;
 - c. Në fushën e transportit: transporti publik, infrastruktura për automjete elektrike, skema të qiradhënies së bicikletave, automjete me shkarkime të pakta;
 - d. Në fushën e ujërave: investimet për përshtatjen ndaj ujërave të shirave/stuhive, investimet për grumbullimin e ujërave tëshirave, trajtimi dhe riciklimi i ujërave, përshtatja e rrugëve ujore;
 - e. Në fushën e menaxhimit të mbetjeve: kapja e metanit, shndërrimi i mbetjeve në lëndë djegëse;
 - f. Në fushën e përdorimit të tokës: pylltaria dhe zinxhirët e furnizimit të qëndrueshëm, bujqësia e qëndrueshme;
 - g. Në fushën e përshtatjes së infrastrukturës: përshtatja e infrastrukturës ndaj rritjes së temperaturave, ri-zhvillimi i porteve për të trajtuar rritjen e nivelit të detit, mbrojtja nga stuhitë.

Neni 37 - Transferimi i teknologjive/ teknologjitë me pak karbon

1. Të gjitha ministritë e linjës dhe autoritet e tjera kompetente të përcaktuara në Keun III të këtij ligji në fushat e tyre të përgjegjësisë shtetërore do të:
 - a. dekurajojnë transferimin e teknologjive të vjetra, do të inkurajojnë kërkime në shkencë e teknologji, si dhe zhvillimin, transferimin dhe përdorimin e teknologjive, paisjeve dhe proceseve për zbutjen e ndryshimeve klimatike (reduktimin e shkarkimeve të GES) dhe përshtatjen (për të reduktuar vulnerabilitetin) ndaj ndryshimeve klimatike, me qëllim që të përmirësojnë performancën mjedisore dhe të mbështetin zhvillimin e qëndrueshëm;
 - b. inkurajojnë vendosjen e bashkëpunimit ndërkombëtar që synon dhënien e ndihmës për transferimin e *know-how*, të aftësive teknike dhe menaxheriale për zhvillimin e institucioneve dhe rrjeteve të nevojshme, për sigurimin e pjesëmarrjes së aktorëve private dhe publikë;
 - c. përshtatin standardet e duhura dhe nxitin marrëveshjet vullnetare midis trupave dhe organizatave që përfaqësojnë interesa të caktuara, grupe operatorësh dhe operatorë të vecantë dhe autoritetet përkatëse për të nxitur zhvillimin e teknologjive eficiente;
2. Projektet për kërkim, zhvillim, novacion dhe transferim të teknologjive të referuara në paragrafin 1 të këtij Neni, do të jenë në përputhje me prioritetet dhe nevojat e përcaktuara në strategjitë sektoriale të zhvillimit LCDS, Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe programet për mjedisin dhe klimën.

Neni 38 - Iniciativa/ përfshirja e sektorit privat

Për të arritur objektivat e reduktimit të shkarkimeve kombëtare të GES të përcaktuara në NDC të gjitha ministrinë e linjës do të nxitin përfshirjen e sektorit privat dhe partneritetin me të.

Neni 39 - Fondet kombëtare dhe ndërkombëtare për ndryshimet klimatike

1. Të gjitha autoritetet kompetente sipas këtij ligji do të nxitin zhvillimin e projekteve dhe programeve lokale dhe kombëtare dhe pjesëmarrjen në projekte dhe programe rajonale dhe ndërkombëtare që synojnë arritjen e objektivave për reduktimin e shkarkimeve të GES dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
2. Ministria përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së huaj do të bashkëpunojë me Ministrinë dhe ministrinë e linjës të përcaktuara në nenin 30 Paragrafi 2, për të siguruar integrimin e çështjeve të klimës edhe në projekte e programe të tjera në mënyrë që vendi të përfitojë nga fondet ndërkombëtare respektive.
3. Fondi i mjedisit, i referuar në ligjin për mbrojtjen e mjedisit, do të përdoret edhe për të mbështetur zbatimin e masave për zbutje dhe përshtatje sipas kërkesave të këtij ligji dhe prioritetet e dokumentave politikë kombëtarë për ndryshimet klimatike.
4. Mekanizmi i Zhvillimit të Paster (CDM) i Protokollit të Kiotos mund të përdoret si një kuadër për zbatimin e aktiviteteve të projekteve që synojnë të zbutin shkarkimet antropogjene në RSH.
5. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton vendimin mbi krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar për Mekanizmin e Zhvillimit të Paster (CDM) në kuadër të Protokollit të Kiotos.

KREU VI - Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 40 - Menaxhimi i informacionit

1. Brenda 6 muajsh nga publikimi i këtij ligji në fletoren zyrtare, AKM do të publikojë listën e instalimeve të Aneksit II, Pjesa A, që ndodhen në territorin e RSH.
2. Ministria përgjegjëse për transportin, brenda 5 vitesh nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, do të publikojë listën e operatorëve të avionëve që kanë qenë licencuar prej saj gjatë vitit të mëparshëm dhe që kanë kryer aktivitete aviacioni që mbulohen nga ky ligj; dhe brenda datës 1 Shkurt të cdo viti në vazhdim do të përditësojë listën e referuar në paragrafin 4.
3. AKM do të mbajë dhe përditësojë regjistrin me të dhëna për instalimet e referuara në paragrafin 1.
4. Regjistri dhe lista e instalimeve të referuara në paragrafin 1 dhe lista e operatorëve të avionëve të referuara në paragrafin 2 janë pjesë e sistemit të informacionit mjedisor.
5. Informacioni i referuar në paragrafin 3 do të përfshijë edhe vendimet dhe raportet mbi rezultatet monitorimit, raportimit dhe verifikimit të shkarkimeve të GES.
6. Vendimet që lidhen me raportet e shkarkimeve të GES që kërkohen nga leja e mjedisit që përfshin edhe GES dhe që mbahen nga AKM do të bëhen të disponueshme për publikun menjëherë dhe rregullisht duke siguruar akses të pa-diskriminuar në përputhje me Vendimin “Për të drejtën e publikut për të patur akses në informacionin mjedisor”.
7. Pjesa e të dhënave të referuara në këtë nen dhe që sipas legjislacionit “Për informacionin”, klasifikohen si “Sekret shtetëror” apo që janë subjekt i legjislacionit “Për të dhënat personale,

profesionale dhe tregtare” nuk do të bëhen publike dhe nuk do të transferohen nga një autoritet tek tjetri, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga ky legjislacion.

Neni 41 - Përputhshmëria e operatorëve me kërkesat e këtij ligji

1. Operatorët e instalimeve që përfshihen në Aneksin II, Pjesa A të këtij ligji, kanë detyrimin të marrin të gjitha masat që brenda 5 vitesh nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, të kenë plotësuar kërkesat e këtij ligji dhe të akteve të tij nën-ligjore.
2. Operatorët e avionëve që janë subjekt i këtij ligji kanë detyrimin të marrin të gjitha masat e nevojshme që brenda 5 vitesh nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare, të kenë plotësuar kërkesat e këtij ligji dhe të akteve të tij nën-ligjore.
3. Operatorët e anijeve që janë subjekt i këtij ligji do të marrin të gjitha masat e nevojshme që brenda 5 vitesh nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare të kenë plotësuar kërkesat e këtij ligji dhe të akteve të tij nën-ligjore.

Neni 42 - Raportimi mbi zbatimin e Seksionit 1 dhe 2 të këtij ligji

1. Cdo vit AKM do të përgatitë një raport për zbatimin e kërkesave mbi monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES që kërkohen nga ky Ligj dhe aktet e tij nën-ligjore.
2. Raporti i parë do të përgatitet pas 1 viti nga data e referuar në nenin 5, paragrafi 1.
3. Ministri miraton një Urdhër për formatin e pyetësorit apo të përmbajtjes së raportit.
8. Ministri miraton me Urdhër raportin e referuar në paragrafin 1.

Neni 43 - Aktet nën-ligjore

4. Këshilli i Ministrave miraton aktet nën-ligjore sipas Nenit brenda 4 vjetësh nga data e botimit të tij në Fletoren Zyrtare.
5. Ministri miraton aktet nën-ligjore sipas Nenit brenda 4 vjetësh nga data e botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Neni 44 - Akte nën-ligjore që mbeten në fuqi

1. Vendimi nr. 865, datë 10.12.2014 “Për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara” do të vazhdojë të mbetet në fuqi sikur të jetë miratuar në zbatim të Nenit 20 të këtij ligji.
2. Vendimi nr. 762, datë 16.9.2015 “Për miratimin e dokumentit për përcaktimin e kontributit kombëtar të pikësnyar kundrejt arritjes së objektivit të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike” do të vazhdojë të mbetet në fuqi sikur të jetë miratuar në zbatim të Nenit 23 të këtij ligji.
3. Urdhëri i Kryeministrit no.155, dt. 25.04.2014 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërministror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike” do të vazhdojë të mbetet në fuqi sikur të jetë miratuar në zbatim të Nenit 30 të këtij ligji.
4. Vendimi Nr.1553, datë 26.11.2008 “Për krijimin e autoritetit kombëtar të përcaktuar të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të protokollit të Kiotos” do të vazhdojë të mbetet në fuqi sikur të jetë miratuar në zbatim të Nenit 39 të këtij ligji.

Neni 45 - Shfuqizime

Në Aneksin e Vendimit nr. 1189, date 18.11.2009 “Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, paragrafi Ç.1 “Treguesit mjedisorë të trysnisë në mjedis” që lidhen me ndryshimet klimatike, pika a dhe b, shfuqizohen.

Neni 46 - Kundërvajtjet

1. Përvec kundërvajtjeve të përcaktuara në ligjin “Për lejet e mjedisit”, shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
 - a. Zhvillimi i një aktiviteti të referuar në nenin 5, paragrafi 1 të këtij ligji, pas datës së caktuar, pa leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES dënohet me gjobë sikur të zhvillohej pa leje mjedisi, sipas Ligjit “Për lejet e mjedisit”, neni 29, gërma a, pika i apo ii;
 - b. Mos përmbushja e detyrimit për monitorimin e shkarkimeve të GES dhe raportimin e tyre në AKM sipas kërkesave të nenit 10 dhe 11 të këtij ligji apo akteve të tij nën-ligjore, nga cilido operator dënohet me gjobë sipas Ligjit “Për lejet e mjedisit”, neni 29, gërma b;
 - c. Mosnjoftimi në AKM i ndryshimeve të parashikuar në nenin 9, për të cilin mund të nevojitet një përditësim i lejes së mjedisit që përfshin shkarkimet e GES lidhur me shkarkimin e këtyre, dënohet me gjobë sipas Ligjit “Për lejet e mjedisit”, neni 29, gërma c;

Neni 47 - Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqipas botimit në Fletoren Zyrtare.

Aneksi I: Gazet me Efekt Serrë

Që referohen në nenin 2, pika 11

1. Dioksid karboni (CO₂)
2. Metan (CH₄)
3. Monoksid azoti (N₂O)
4. Hegzafluorid i squfurit (SF₆)
5. Trifluorid azoti (NF₃)
6. Hidrofluorokarbone (HFCs) dhe
 - HFC-23 CHF 3
 - HFC-32 CH 2 F 2
 - HFC-41 CH 3 F
 - HFC-125 CHF 2 CF 3
 - HFC-134 CHF 2 CHF 2
 - HFC-134a CH 2 FCF 3
 - HFC-143 CH 2 FCHF 2
 - HFC-143a CH 3 CF 3
 - HFC-152 CH 2 FCH 2 F
 - HFC-152a CH 3 CHF 2
 - HFC-161 CH 3 CH 2 F
 - HFC-227ea CF 3 CHF 3
 - HFC-236cb CF 3 CF 2 CH 2 F
 - HFC-236ea CF 3 CHFCHF 2
 - HFC-236fa CF 3 CH 2 CF 3
 - HFC-245fa CHF 2 CH 2 CF 3
 - HFC-245ca CH 2 FCF 2 CHF 2
 - HFC-365mfc CH 3 CF 2 CH 2 CF 3
 - HFC-43-10mee CF 3 CHFCHF 2 CF 3 or (C 5 H 2 F 10)
7. Perfluorokarbone (PFCs):
 - PFC-14, Perfluoromethane, CF 4
 - PFC-116, Perfluoroethane, C 2 F 6
 - PFC-218, Perfluoropropane, C 3 F 8
 - PFC-318, Perfluorocyclobutane, c-C 4 F 8
 - Perfluorocyclopropane c-C 3 F 6
 - PFC-3-1-10, Perfluorobutane, C 4 F 10
 - PFC-4-1-12, Perfluoropentane, C 5 F 12
 - PFC-5-1-14, Perfluorohexane, C 6 F 14
 - PFC-9-1-18, C 10 F 18

Aneksi II: Kategoritë e aktiviteteve dhe GES që i nënshtrohen kërkesave të këtij ligji

Që referohen në seksionin 1

1. Instalimet apo pjesë të tyre që përdoren për kërkim, zhvillim dhe testim të produkteve dhe proceseve të reja dhe instalimet që përdorin ekskluzivisht biomasën përjashtohen nga ky ligj.
2. Vlerat prag që jepen më poshtë përgjithësisht i referohen kapaciteteve prodhuese ose vëllimit të prodhimit. Për aktivitetet që bien nën të njëjtën kategori dhe kryhen në të njëjtin instalim, kapacitetet e tyre mbledhen së bashku.
3. Për llogaritjen e inputit termal nominal total të një instalimi ku digjen lëndë djegëse, mbledhen inputet termale nominale të të gjitha njësive teknike që janë pjesë e tij. Këto njësi mund të përfshijnë të gjitha tipet e bojlerëve, të paisjeve për djegje, turbinave, paisjeve ngrohëse, furnaltave/kaldajave, incineratorëve, kalcinatorëve, furrave të cimentos, furrave të pjekjes, paisjeve tharëse, motorrëve, qelizave të lëndës djegëse, njësitë e djegies me fryrje kimike, flakëruesve dhe njësive termale apo katalitike pas djegies. Në këtë llogaritje nuk do të merren në konsideratë njësitë me input nominal termal nën 3 MW dhe njësitë që përdorin ekskluzivisht biomasën. “Njësitë që përdorin ekskluzivisht biomasën” janë njësitë që përdorin lëndë djegëse fosile gjatë ndezjes apo fikjes së njësisë.
4. Kur rezulton se në një instalim që ka një leje mjedisi, kapërcehet pragu i kapacitetit të një aktiviteti që listohet në këtë aneks, leja e mjedisit e të gjitha njësive ku digjet lëndë djegëse, përveç njësive për incinerimin e mbetjeve të rrezikshme ose bashkiake, do të ketë edhe kërkesa për shkarkimet e GES sipas nenit 5 të këtij ligji.

Nr.	Aktivitetet	GES
1.	Djegia e lëndëve djegëse në instalime (përveç instalimeve për incinerimin e mbetjeve të rrezikshme apo bashkiake) me input termal nominal total mbi 20 MW	Dioksid karboni
2.	Rafinimi i vajrave minerale	Dioksid karboni
3.	Prodhimi i koksit	Dioksid karboni
4.	Pjekja ose aglomerimi, përfshirë peletizimin, i xeherorëve metalikë, përfshirë xeherorët sulfidë	Dioksid karboni
5.	Prodhim i gizës ose çelikut (shkrirje primare dhe sekondare) përfshirë derdhjen e vazhdueshme me kapacitet prodhues më të madh se 2,5 tonë/orë	Dioksid karboni
6.	Prodhimi apo përpunimi i metaleve ferroke, përfshirë aliazhet e tyre, me njësi djegie që operojnë me input termal nominal total mbi 20 MW. Përpunimi i metaleve ferroke përfshin mullinj të me rula, ngrohësit e ndërmjetëm, furnaltat, kovacanat, fonderitë, veshjen me metal të shkrirë dhe fiksimin e ngjyrës/elektrolitik.	Dioksid karboni
7.	Prodhimi i aluminit primar	Dioksid karboni dhe perfluorokarbone
8.	Prodhimi i aluminit sekondar me njësi djegie që operojnë me input termal nominal total mbi 20 MW.	Dioksid karboni
9.	Prodhimi apo përpunimi i metaleve jo-ferroke, përfshirë prodhimin e aliazheve, rafinimin, derdhjen në fonderi, etj., me njësi djegie që operojnë me input termal nominal total mbi 20 MW (përfshirë lëndët djegëse që përdoren si agjentë reduktues)	Dioksid karboni
10.	Prodhimi i klinkerit të çimentos në furra rrotulluese me kapacitet prodhues mbi 500 ton/ditë ose në furnalta të tjera me kapacitet prodhues mbi 50 ton/ditë	Dioksid karboni
11.	Prodhimi i gëlqeres ose kalcinimi i dolomiteve apo magnezitit në furra rrotulluese apo në furnalta të tjera me kapacitet prodhues mbi 50 tonë/ditë	Dioksid karboni
12.	Prodhimi i qelqit dhe fibrave të qelqit me kapacitet shkrirje mbi 20 tonë/ditë	Dioksid karboni
13.	Prodhim i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit me kapacitet prodhues mbi 75 tonë/ditë	Dioksid karboni

14.	Prodhimi i materialeve izoluese me bazë leshi mineral, duke përdorur qelq, gurë apo skorrje me kapacitet shkrirje mbi 20 tonë/ditë	Dioksid karboni
15.	Tharja ose kalcinimi i gipsit apo prodhimi i fletëve/ pllakave/ paneleve prej gipsi, dhe produkteve të tjera prej gipsi, me njësi djegie që operojnë me input termal nominal total mbi 20 MW	Dioksid karboni
16.	Prodhimi i pulpës nga trungjet e drurit dhe materiale të tjera fibroze	Dioksid karboni
17.	Prodhimi i letrës dhe/ ose i kartonit me kapacitet prodhues mbi 20 ton/ ditë	Dioksid karboni
18.	Prodhimi i katranit nga karbonizimi i substancave të tilla si vajra, zift, fishekzjarre, paisje krekingu, dhe mbetje distilimi, me njësi djegie që operojnë me input termal nominal total mbi 20 MW	Dioksid karboni
19.	Prodhimi i acidit nitrik	Dioksid karboni dhe oksid azoti
20.	Prodhimi i acidit adipik	Dioksid karboni dhe oksid azoti
21.	Prodhimi i acidit gliksal dhe gliksilik	Dioksid karboni and oksid azoti
22.	Prodhimi i amoniakut	Dioksid karboni
23.	Prodhimi i shumicës së kimikateve organike përmes krekingut, reformimit, oksidimit të pjesshëm apo të plotë apo proceseve të ngjashme, me kapacitet prodhues mbi 100 ton/ ditë	Dioksid karboni
24.	Prodhimi i hidrogjenit (H ₂) dhe gazit të sintezës përmes reformimit apo oksidimit të pjesshëm me kapacitet prodhues mbi 25 ton/ ditë	Dioksid karboni
25.	Prodhimi i hirit të sodës (Na ₂ CO ₃) dhe bikarbonatit të sodës (NaHCO ₃)	Dioksid karboni
26.	Kapja e rrymave të GES nga instalimet që mbulohen nga ky Ligj për qëllime të transportimit dhe depozitimit gjeologjik në një vend depozitimi për të cilën AKM ka lëshuar një leje mjedisi	Dioksid karboni
27.	Transportimi i GES përmes tubacioneve për depozitimin gjeologjike në një vend depozitimi për të cilën AKM ka lëshuar një leje mjedisi	Dioksid karboni
28.	Depozitimi gjeologjik i GES në një vend depozitimi për të cilën AKM ka lëshuar një leje mjedisi	Dioksid karboni

Aneksi III: Lista e aktiviteteve të aviacionit që përjashtohen nga ky ligj

Që referohen në nenin 12

<p>(a) fluturimet që kryhen eskuzivisht për transportin për misione zyrtare të një Monarku në fuqi dhe familjes së ngushtë të tij, të Kryetarëve të Shteteve dhe ministrave të vendeve që nuk janë antarë të BE, kur një gjë e tillë është treguar në planin e fluturimit;</p> <p>(b) fluturimet ushtarake që kryhen nga avionë ushtarakë dhe fluturimet e autoriteteve të doganave dhe të policisë;</p> <p>(c) fluturimet për misione kërkimi dhe shpëtimi, për shuarje zjarresh, për ndihma humanitare dhe shërbime shëndetsore emergjente të autorizuara nga autoritetet kompetente përkatëse;</p> <p>(d) cdo fluturim që kryhet eskuzivisht sipas rregullave të shikueshmërisë së fluturimit, sipas përcaktimit të bërë në aneksin 2 të Konventës së Cikagos;</p> <p>(e) fluturimet që përfundojnë në aerodromin e nisjes pa bërë asnjë ulje të ndërmjetme;</p> <p>(f) fluturimet për trainim që kryhen eskuzivisht për marrjen e licencës, apo për vlerësim në rastin e ekuipazhit të fluturimit kur kjo është përcaktuar me shënimin e duhur në planin e fluturimit, me kusht që ai fluturim të mos shërbejë për transportin e pasagjerëve dhe/ose kargove apo për pozicionimin apo transportimin e avionit;</p> <p>(g) fluturimet që kryhen eskuzivisht për qëllime të kërkimit shkencor apo për kontrollimin, testimin apo certifikimin e avionit apo paisjeve qoftë në ajër apo në tokë;</p> <p>(h) fluturimet që kryhen nga një avion që ka masë maksimale ngritje të certifikuar prej më pak se 5,700 kg;</p> <p>(i) fluturimet që kryhen mbi rrugët ajrore kur kapaciteti i ofruar nuk është më i madh se 30 000 vende në vit;</p> <p>(j) fluturimet që, përveçse në këtë rast, do të binin në aktivitetin e kryer nga një operator tregtar transporti ajror që operon ose:</p> <ul style="list-style-type: none">— më pak se 243 fluturime në periudhë, për 3 periudha katër mujore konsekuative, ose— fluturimet me shkarkime totale vjetore më të ulta se 10,000 ton në vit. <p>Fluturimet që kryhen eskuzivisht për transportin, për misione zyrtare të një Monarku në fuqi dhe familjes së ngushtë të tij, të Kryetarëve të Shteteve dhe ministrave të vendeve që nuk janë antarë të BE, mund të mos përjashtohen sipas kësaj pike; dhe</p> <p>(k) fluturimet që, me përjashtim të kësaj pike, do të binin në këtë aktivitet, që kryhet nga një operator jo-tregtar avioni që operon fluturime me shkarkime totale vjetore më të ulta se 1,000 ton në vit.</p>	Dioksid karboni
--	-----------------

Aneksi IV: Lista jo-shterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin “Përcaktimi i kontributit kombëtar të pikësnyuar (NDC)”

Që referohen në nenin 23

1. Kontributi kombëtar në zbutjen e ndryshimeve klimatike;
2. Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike;
3. Informacion për procesin e planifikimit dhe masat e zbatimit, përfshirë zbatimin e planeve kombëtare ku bazohet vetë dokumenti;
4. Mbështetjen ndërkombëtare të nevojshme për
 - a. procesin e planifikimit lidhur me financimin;
 - b. transferimin e teknologjisë; dhe
 - c. ngritjen e kapaciteteve

Aneksi V: Lista jo-shterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin LCDS

Që referohen në nenin 24

1. Përshkrimin e kontekstit socio-ekonomik, demografik dhe gjeografik për zhvillime me pak karbon;
2. Vlerësimin e shkarkimeve ekzistuese të GES sipas sektorëve dhe shkarkimet e pritshme në periudhën afat-mesme dhe afat-gjatë;
3. Vlerësimin e opsioneve teknologjike në sektorë prioritarë;
4. Analizën e mundësive të zbatimit të opsioneve për zhvillime me pak karbon në sektorë të rëndësishëm;
5. Zgjedhjen e opsioneve të duhur për tu zbatuar në periudhën afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjatë në mënyrë që të plotësohen objektivat e përcaktuar në NDC, të referuara në Nenin 23;
6. Koordinimin dhe sinergjinë me marrëveshje mjedisore ndërkombëtare/ shumëpalëshe, proceset dhe mundësitë për financim.

Aneksi VI: Lista jo-shterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin NAMA

Që referohen në nenin 25

Hyrje	<p>a. Përshkrim i shkurtër i situatës së përgjithshme të vendit dhe pasqyra e zhvillimit kombëtar dhe politikave për ndryshimet klimatike;</p> <p>b. Përshkrim i shkurtër i kuadrit ekzistues ligjor, rregullator dhe institucional për zbatimin e NAMA;</p>
Pasqyra e NAMA	<p>c. Përshkrim i objektivave dhe masave zbutëse;</p> <p>d. Rëndësia që ka për planet/strategjitë e zhvillimit kombëtar, si dhe objektivat kombëtare dhe/ose sektoriale për zbutjen e ndryshimeve klimatike;</p> <p>e. Përshkrim i iniciativave ekzistuese për zbutje që kanë lidhje dhe bëjnë sinergji me NAMA;</p> <p>f. Përshkrim i shkurtër i ndikimit transformues, përfshirë qëndrueshmërinë e tij;</p>
Përfitimet kombëtare	<p>g. Përshkrim i përfitimeve në terma të zhvillimit (ekonomik, social dhe mjedisor);</p> <p>h. Raporti kosto-efektivitet në arritjen e përfitimeve kombëtare;</p>
Ndikimet nga shkarkimet e GES	<p>i. Përshkrim i skenarit bazë BAU scenario;</p> <p>j. Përshkrim i ndikimeve të vlerësuara mbi devijimin në shkarkimet e GES nga skenari bazë BAU;</p> <p>k. Përshkrim i ndikimit transformues nga zbatimi i NAMA;</p> <p>l. Raporti kosto-efektivitet në arritjen e ndikimeve nga shkarkimet e GES;</p>
Plani i veprimit të NAMA	<p>m. Përshkrim i aktiviteteve të detajuara për të zbatuar masat zbutëse të përfshira në NAMA;</p> <p>n. Plani i punës për aktivitetet e detajuara;</p> <p>o. Plani për angazhimin e aktorëve, përfshirë rolin e tyre në zbatimin e aktiviteteve dhe rregullimeve institucionale;</p>
MRV	<p>p. Përshkrim i parametrave kryesorë për vlerësimin e progresit në zbatimin e NAMA;</p> <p>q. Përshkrim i parametrave kryesorë për vlerësimin e përfitimeve kombëtare dhe ndikimin e shkarkimeve të GES;</p> <p>r. Përshkrim i metodologjisë për vlerësimin e ndikimit të shkarkimeve të GES dhe rregullimet për matjen dhe raportimin e tyre;</p>
Mbështetja e jashtme jo-	s. Përshkrim i nevojave teknike dhe për ndërtimin e kapaciteteve, bazuar në

financiare që kërkohet	barrierat e identifikuara për zbatimin e masave zbutëse (përshkruar në Aneks);
Mbështetja financiare që kërkohet	t. Kostot e zbatimit të NAMA; u. Kosto shtesë, që nevojitet të sigurohet nga fondet ndërkombëtare për zbatimin e NAMA; v. Përshkrim të rregullimeve për financimin dhe zbatimin e NAMA, përfshirë financimet me burime të vendit dhe ndërkombëtare.
Anekset	
Identifikimi i barrierave	a. Studim para-fizibiliteti për zbatimin e masave zbutëse; b. Analiza e barrierave (financiare, ligjore, rregullatore, institucionale, të kapaciteteve, teknologjisë, etj.) që pengojnë arritjen e objektivave të NAMA; c. Përshkrim i zgjidhjeve dhe hapave të nevojshëm për eleminimin e barrierave;
Procesi i verifikimit	d. Përshkrim i procesit të verifikimit të NAMAVE në vend.

Aneksi VII: Lista jo-shterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin “Strategjia dhe Plani Kombëtar për Përshtatje (NAP)”

Që referohen në nenin 26, paragrafi 3

1. Analiza e klimës aktuale dhe skenarët për ndryshimet e ardhëshme klimatike;
2. Vlerësimin e vulnerabilitetit ndaj klimës dhe identifikimin e opsioneve të përshtatjes në nivel sektori, lokal, dhe tjetër sipas rastit;
3. Rishikimin dhe vlerësimin e opsioneve;
4. Zgjedhjen e opsioneve të duhura që duhen zbatuar në periudha afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjatë;
5. Koordinimin dhe sinergjinë me marrëveshje të tjera mjedisore ndërkombëtare/ shumëpalëshe, proceset dhe mundësitë financiare;
6. Identifikimin e qasjeve të duhura për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në politikat dhe strategjitë e ministrive të linjës;
7. Specifikimin e nevojave financiare për përshtatje dhe burimet potenciale për mbulimin e shpenzimeve;
8. Qasjen për zhvillimin e kapaciteteve, rritjen e tyre dhe angazhimin public;
9. Koordinimin dhe sinergjinë me marrëveshje të tjera mjedisore ndërkombëtare dhe shumëpalëshe;

Aneksi VIII: Lista jo-shteruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin Komunikimi Kombëtar

Që referohen në nenin 29, paragrafi 3

1. Inventari kombëtar i shkarkimeve antropogjene sipas burimeve dhe përthithjes nga përthithësit e GES, në atë masë që lejojnë kapacitetet e vendit, dhe duke përdorur metodologji të krahasueshme me ato që promovon Konventa;
2. Përshkrim të përgjithshëm të hapave të ndërmarrë apo të parashikuar për zbatimin e Konventës, përfshirë programet kombëtare, apo sipas rastit, edhe rajonale, që përmbajnë masa për zbutjen dhe për lehtësimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike;
3. Përshkrimin e të gjitha rregullimeve institucionale ekzistuese;
4. Masat e zbatuara për të lehtësuar zbutjen e ndryshimeve klimatike;
5. Masat e zbatuara për të lehtësuar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Ky informacion duhet të përfshijë objektivat kryesore dhe kategorinë e ndryshimeve klimatike që është trajtuar, si psh përbytyet, ngritjen e nivelit të detit, temperaturat ekstreme, thatësitrat, dhe ngjerje të tjera të ekstreme të motit;
6. Gjetje të reja për ndryshimet klimatike dhe cënueshmërinë në Shqipëri;
7. Progresi i bërë dhe pengesat për integrimin e zbutjes dhe përshtatjes në sektorë të tjerë dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
8. Progresi i bërë dhe pengesat për arritjen e objektivave dhe indikatorëve të zbutjes dhe përshtatjes;
9. Kufizimet dhe mangësitë, nevojat financiare, teknike dhe për kapacitete si për çështje të zbutjes ashtu edhe të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike;
10. Tabelat për sektorët dhe nën-sektorët e inventarit si dhe fletët e punës në excel të plotësuara për çdo kategori aktiviteti me të dhënat përskatëse, sipas kërkesave të metodologjisë së përdorur.
11. Informacion mbi nivelin e pasigurisë të të dhënave të inventarit dhe supozimeve të bëra për të tione, bashkë me përshkrimin e metodologjisë së përdorur për vlerësimin e pasigurisë, sipas rastit.
12. Kufizimet lidhur me disponibilitetin dhe/apo cilësinë e të dhënave dhe informacionit të përdorur dhe të dokumentit të prodhuar me to.
13. Cdo informacion tjetër që konsiderohet i rëndësishëm për arritjen e objektivave të NDC dhe të Konventës dhe që është i përshtatshëm për tu përfshirë në këtë komunikim, përfshirë, nqse është e mundur, material mbi llogaritjen e tendencës së shkarkimeve globale, transferimin e teknologjive, kërkimin dhe vëzhgimet sistematike, edukimin, trajnimin dhe ndërgjegjësimin publik, ngritjen e kapaciteteve, informimin dhe rrjetëzimin.
14. Rekomandime për hapa dhe masa të mëtejshme si për zbutjen dhe për përshtatjen.

Aneksi IX: Lista jo-shterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin BUR

Që referohen në nenin 29, paragrafi 4

1. Situata në vend, përfshirë prioritetet e zhvillimit të vendit dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, rregullimet institucionale për përgatitjen në vazhdimësi të Komunikimit Kombëtar, përfshirë rregullimet ligjore dhe zyrtare, të vendosura, apo të përforcuara, për të mbështetur procesin e përgatitjes rregullisht të Komunikimit Kombëtar dhe Raporteve të Përditësimit Dyvjeçar;
2. Inventari i shkarkimeve antropogjene sipas burimeve dhe tërheqjes nga përthithësit e gjithë të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit/ Rregulloren Kombëtare për përgatitjen e NC dhe BUR, sipas nenit 29, paragrafi 7, përfshirë raportin kombëtar për inventarin e shkarkimeve;
3. Informacion për masat zbutëse dhe efektet e tyre, përfshirë metodologjitë dhe supozimet që lidhen me to;
4. Kufizimet dhe mangësitë, nevojat financiare, teknike dhe për kapacitete, mbështetjen e nevojshme dhe atë të siguruar;
5. Informacion për nivelin e mbështetjes së siguruar për mundësimin e përgatitjes dhe dorëzimit të Raportit të Përditësimit Dyvjeçar;
6. Informacion mbi MRV në nivel kombëtar;
7. Informacion për NAMAt si me poshtë:
 - a. informacion për NAMAt: objektivin dhe përshkrimin e NAMAVE, informacion për burimet e shkarkimeve që trajtohen në NAMAt (psh sektorët dhe gazet) dhe objektivat sasiore; hapat e parashikuar për zbatimin e NAMAVE; indikatorët e progresit që ndjekin zbatimin e NAMAVE; metodologjitë dhe supozimet që lidhen me vlerësimin e ndikimeve të NAMAVE në shkarkimin e GES; barrierat për zbatimin e NAMAVE, dhe nevojat financiare, teknike dhe për kapacitete që lidhen me to, bashkë me përshkrimin e nevojës për mbështetje.
 - b. Informacion për NAMAt, zbatimin e tyre ka përfunduar dhe atyre që janë në proces: progresin e NAMAVE që janë në proces zbatimi, përfshirë hapat e ndërmarrë dhe ato që parashikohen të merren në vazhdim; rezultatet e arritur nga zbatimin e NAMAVE dhe ndikimin e tyre të shprehur si reduktim i shkarkimeve të GES. Rezultatet e NAMAVE janë rezultati direkt i zbatimit të tyre, psh i politikave që nxitin masat për efikasitetin e energjisë apo ngritjen e kapaciteteve për energji të rinovueshme, etj.
 - c. Informacion për mbështetjen: mbështetjen internacionale që nevojitet dhe atë të siguruar, për të zhvilluar apo zbatuar NAMAt.
8. Tabelat me rezultatet, fletët e punës për sektorët dhe nën-sektorët të plotësuar me të dhënat përkatëse, sic kërkohet nga metodologjia e përdorur.
9. Tabela me përmbledhjen e informacionit të inventarëve të viteve të mëparshëm.
10. Kufizimet në disponibilitetin dhe/apo cilësinë e të dhënave dhe informacionit si dhe të dokumentit të prodhuar me to.
11. Cdo informacion tjetër që konsiderohet i rëndësishëm për arritjen e objektivit të Konventës dhe që është i përshtatshëm për tu përfshirë në Raportin e Përditësimit Dyvjeçar.